

PROCESVERBAL

nga seanca e 5-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime

Mediatike Audio dhe Audiovizuale

mbajtur më 10.02.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencë:
Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë përmes lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm edhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional përmes lidhjes video-konferencë:
mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski e hapi seancën e 5-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuale. Seanca filloi në orën 14:00 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 4-ët e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 05.02.2025.
2. Propozim-vendim për dhënien e ndihmës financiare-donacion për Projektin për efikasitet energjetik për ISHP SBGPM 13 Nëntor Shkup dhe Propozim-m për donacion.
3. Të ndryshme

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 4-ët të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 05.02.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-vendimin për dhënien e ndihmës financiare-donacion për Projektin për efikasitet energjetik për ISHP SBGPM 13 Nëntor Shkup dhe Propozim-marrëveshjen për donacion. Ai ka shpjeguar se në njërin nga seancat paraprake është miratuar ribalanci i Planit Financiar, ku një nga pikat ka qenë për donacionin e lartpërmendur. Me propozim të z. Trajçev, donacioni do t'i bëhet ISHP SBGPM 13 Nëntor Shkup, e jo siç ishte më parë kur pika ishte shënuar për Shoqatën për Mbështetjen e Pacientëve Paliativ dhe Familjeve të tyre PALIUM Shkup. Ai tha se për donacionin Agjencia do të lidhë Marrëveshje për donacion me ISHP SBGPM më 13 nëntor Shkup dhe do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim që Drejtori i agjencisë të marrë Vendim për dhënien e ndihmës financiare - donacion për Institucionin publik shëndetësor - Spitali i specializuar për mjekësi paliative geriatrike "13 Nëntori" Shkup, në shumë prej 1.000.000,00 (një milion) denarë, për realizimin e "Projektit për efikasitet energjetik për ISHP SBGPM 13 Nëntori Shkup" qëllimi i të cilit është vendosja e një sistemi të ri vetë-qëndrueshëm për ngrohjen e ujit përmes sistemi të kolektorit diellor, që është në energji më efikas se sistemi që përdoret aktualisht nga spitali, më kosto-efektiv, më ekonomik dhe ekologjik, i cili do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nëpërmjet kujdesit më cilësor dhe higjienës personale për pacientët geriatrikë dhe paliativë, zvogëlimin e faturave të energjisë elektrike të spitalit, si dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, zhvillim të gjelbërimit, zvogëlimin e ajrit të ndotur dhe ndikim në ndryshimet klimatike.

Mjetet financiare të lartpërmendura janë të parashikuara në Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive për vitin 2025 dhe të njëtit pagohen në xhironlogari të Trezorit të Shëndetësisë : 100000000066005, Banka pranuese: Banka Kombëtare e RSM-së, Llogaria e përdoruesit buxhetor – përdorues i vetëm: 660250005953198, shifra e të ardhurave dhe programi: 744111 00.

Për dhënien e ndihmës financiare - donacion nga Vendimi i lartpërmendur, lidhet Marrëveshja për donacion ndërmjet Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive dhe ISHP SBGPM 13 Nëntori Shkup, e cila hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese, dhe do të aplikohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

Pika 3

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**